

NË EMËR TE POPULLIT

GJYKATA E QARKUT E MITROVICËS në panelin gjykues të përbërë nga gjykatës të EULEX-it, Jonathan Welford-Carroll si Kryetar i Trupit Gjykues, dhe Presidenti Xhevdet Abazi dhe Gjykatësja e EULEX-it Caroline CHARPENTIER si anëtarë të trupit gjykues, me pjesëmarrjen e keshilltares ligjore të EULEX-it Tara Khan si procesmbajtëse, në çështjen penale kundër:

SALI REXHEPIT i akuzuar, në bazë të Aktakuzës së PSRK-së PPS nr. 117/2010 të paraqitur më 29 dhjetor 2010 dhe e konfirmuar më 25 mars 2011 me Aktvendimin KA nr. 208/2010 dhe e bashkuar me rastin P nr. 45/2010 gjatë seancës së shqyrtimit kryesor më 04 Maj 2011, me tre akuza për **Krime Luftë Kundër Popullsisë Civile** në shkelje të Neneve 22 dhe 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë ("KPRSFJ"), parashikuar edhe në nenet 23 dhe 120 të Kodit Penal të Kosovës ("KPK"), dhe në kundërshtim me nenin e Përbashkët 3 të Konventave të Gjenevës dhe të neneve 4 dhe 5 (1) të Protokollit II Shtesë të Konventës së Gjenevës;

Pas mbajtjes së seancave të hapura publike të shqyrtimit kryesor në datat në vijim:

- 14, 16, 21, 23, 24, 28, 31 mars 2011;
- 04, 06, 07 prill 2011;
- 04, 05, 16, 19, 23, 25 maj 2011;
- 02, 08, 09, 10, 20 qershor 2011;
- 12 tetor 2011;

Këto të gjitha në prani të PSRK-së, Prokurorit Maurizio Salustro¹, dhe nga bashkimi i lëndës i datës 04 Maj 2011 e tutje në prani të të pandehurit Sali Rexhepi dhe mbrojtësit të tij Qazim Qerimi;

Pas deliberimit dhe votimit, në bazë të 392 paragrafi (1) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës ("KPPK"), më 13 tetor 2011 Trupi Gjykues shpall përpara publikut dhe në praninë e të gjithë palëve të lartpërmendura në vijim kete:

AKTGJYKIM

I Akuzuari **SALI REXHEPI**, i biri i Miftar Rexhepit dhe Nurije Himajt, i lindur me 12 korrik 1956 në Fshatin Rashkoc, Komuna e Gjakovës, aktualisht me banim në Gjakovë, ID nr. 1009230218;

¹ Me përjashtim të atyre ditëve kur ai ka dërguar një zëvendësim të autorizuar.



NUK SHPALLET FAJTOR

Në (Piken 1) Krime të Luftës Kundër Popullsisë Civile

- sepse nuk është vërtetuar se gjatë periudhës prill deri në mes të qershorit 1999, gjatë kohës së konfliktit të brendshëm të armatosur në Kosovë, i Akuzuari në cilësinë e tij si një anëtar i UÇK-së ndersa mbante një pozicion komandues në kampin Cahanit, në bashkë-kryerje me Riza Alijan, Haki Hajdarin dhe ushtarë të tjerë të paidentifikuar të UÇK-së, ka trajtuar në menyre cnjerezore (p.sh. me kushte të ndyra të jetesës, mungesa të higjienes së duhur, mungesa të ushqimit dhe ujit), një numër të papërcaktuar të burgosurish civilë të mbajtur në qendrën e mbajtjes së UÇK-së, në kampin e Cahanit.

Prandaj, në pajtim me nenin 390 pika (3) të KPPK,-se i Akuzuari Sali Rexhepi është liruar nga akuza (Pika 1) për Krime Luftë Kundër Popullsisë Civile.

I Akuzuari SALI REXHEPI

SHPALLET FAJTOR

Në (Piken 2) Krime të Luftës Kundër Popullsisë Civile

- Sepse në ose rreth 3 maj 1999, gjatë kohës së konfliktit të brendshëm të armatosur në Kosovë, i Akuzuari në cilësinë e tij si anëtar i UÇK-së, në bashkë-kryerje me Haki Hajdarin, Shaban Hotin dhe ushtarë të tjerë të paidentifikuar të UÇK-së, ka torturuar Dëshmitarin N, ky i fundit një civil Shqiptar/Kosovar i mbajtur në qendrën e paraburgimit të Cahanit duke u përpjekur për të marrë informacione dhe rrëfime nga ai duke e rrahur atë vazhdimisht me shkopinj druri.

Duke vepruar kështu, SALI REXHEPI ka kryer dhe është penalisht përgjegjës për veprën penale të Krimeve të Luftës Kundër Popullsisë Civile në përputhje me nenet 22 dhe 142 të KP RSFJ-së dhe në lidhje me Nenin e Përbashkët 3 të Konventave të Gjenevës dhe të neneve 4 dhe 5 (1) të Protokollit II Shtesë të Konventës së Gjenevës.

I Akuzuari SALI REXHEPI

NUK SHPALLET FAJTOR

Në (Piken 3) Krime të Luftës Kundër Popullsisë Civile



- Sepse nuk është vërtetuar se në ose rreth 9 maj 1999, gjatë kohës së konfliktit të brendshëm të armatosur në Kosovë, i akuzuari në cilësinë e tij si një anëtar i UÇK-së, në bashkë-kryerje me Shaban HOTIN dhe një ushtar tjetër të paidentifikuar të UÇK-së, ka torturuar Dëshmitarin N, një civil Shqiptar/Kosovar i mbajtur në qendrën e paraburgimit të Cahanit duke u përpjekur për të marrë informacione dhe rrëfime nga Dëshmitari N, ndërsa një ushtar i UÇK-se, i paidentifikuar e ka rrahur atë me një shkop druri në duart dhe këmbët e tij.

Prandaj, në pajtim me nenin 390 pika (3) të KPPK-se, i Akuzuari Sali Rexhepi është liruar nga akuzat e (Pika 3) për Krime Luftë Kundër Popullsive Civile.

SALI REXHEPI

DËNOHET

- deri në pesë / 5 / vjet burgim për (Piken 2) Krimeve të Luftës Kundër Popullsive Civile.

I Akuzuari do të rimbursojë shpenzimet e procedurës penale në pajtim me nenin 102 paragrafi (1) të KPPK-se me përjashtim të shpenzimeve të përkthimit, në shumën prej 500.00 Euro.

**Procesmbajtese
Tara Khan**



**Kryetar i Trupit Gjykses
Jonathan Welford-Carroll**